



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	30.04.21	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	01	Shtojcë	10462-12031/1

Zyra e Kryetarit

Kaçanik, 12.04.2021

Duke u bazuar në nenin 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, pas propozimit dhe konsultimit me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të drejtave dhe përgjegjësi si Zyrtar Kryesor Administrativ, kryetari i komunës nxjerr këtë:

V E N D I M


Për lejimin e mjeteve financiare për rregullimin dhe ndërtimin e disa rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut

- I. Me këtë vendim lejohen mjetet buxhetore në shumë prej 18772.37€, për për rregullimin dhe ndërtimin e disa rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut, të kontratë me nr. KA652/20/057/521
 1. Rregullimi me zhavor në rr. Lagj. "Koxhaj
 2. Asfaltimi i rrugës "Hamz Jashari" dhe trotualet te fab. Sillokapori
 3. Rregullimi i rrugës dhe murit mbrojtës ne fshatin Biçecë" Fadil Bunjaku"
 4. Shtrimi me kubëza të betonit i rruges në lagjen "Mureseli"-Doganaj
- II. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij vendimi do të ndahen nga kategoria buxhetore "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në zonat urbane dhe rurale" me Kod 50201, nga Programi Buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i komunës
2. Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe
3. Arkivi komunal.

Besim Ilazi
Kryetar i komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE
EMERGJENCËS
07 Nr. 104/02 - 10826
Kaçanik,



Në bazë të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 17 pika f, Udhëzimit Administrativ (MI) Nr. 09/2017 për Sinjalizim dhe Rregullat e Trafikut Rrugor, Statutit 01 Nr. 60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 3588/2008, Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 02-60/01-4863/20, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës në Kaçanik, merr:

V E N D I M

Për shpalljen e hapësirës për parkingje afër tri banesave kolektive në Rr. "Vëllezërit Çaka" në Kaçanik

1. LEJOHET shfrytëzimi i hapësirës publike për parkimin e automjeteve në hapësirën publike në Rr. "Vëllezërit Çaka" në afërsi të objekteve të banimeve kolektive, zona Kadastrale Kaçanik, parcela 00572-1.
2. Të drejtën për shfrytëzimin e parkimit të automjeteve e kanë banorët e tri banesave kolektive dhe shfrytëzuesit e lokaleve afariste, të këtyre tri banesave kolektive, në Rr. "Vëllezërit Çaka".
3. Për pajisje me leje parkimi në këtë lokacion, duhet të bashkëngjiten këto dokumentacione:
 - a) Libreza e qarkullimit të automjetit,
 - b) Letërnjoftimi,
 - c) Dëshminë e pagesës për shfrytëzimin e parkingut.
4. Për shënimin dhe rregullimin e vendparkimit publik, do të përkujdeset drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Policia e Kosovës, drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Inspeksioni Komunal.


Arsyetim

Në komunën tonë kemi mungesë të vend parkimeve në qendrën urbane, konkretisht banorët dhe bizneset që gjenden në objektin e tri ndërtesave në Rr. "Vëllezërit Çaka", nuk kanë mundësi tjera të shfrytëzimit të parkingjeve publike, andaj kemi vendosur që kjo hapësirë publike të shfrytëzohet përkohësisht për parkim publik për banorët e këtyre ndërtesave.



Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i komunës,
2. Përfaqësuesi i ndërtesave,
3. Policia e Kosovës,
4. Inspektorati komunal dhe
5. Arkivi;



01.Nr. 104/02-10603/21
Kačanik, 12.04.2021

Në bazë të nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut si dhe në bazë të nenit 11 pika 2 të Rregullores NR. 03/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme Komunale, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

**PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT NUMËR 01-104/02-10603/21 TË
DATËS 12.04.2021**

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE
NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim Sahadete Dalloshi anëtarja e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale nuk do të jetë pjesë e komisionit.
2. Komisionit të lartëshënuar i bashkohet zyrtarja komunale Mirlinda Dema.
3. Pjesët tjera të vendimit 01 Nr. 104/02-10603/21 të datës 12.04.2021 mbasin të pandryshuara.
4. Ky plotësim-ndryshim i vendimit bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Për faktin se zyrtarja komunale Sahadete Dalloshi është caktuar anëtare në disa komisione tjera komunale është vendosur që e njëjta të zëvendësohet për shkak të angazhimeve të saja.

Vendimi i dërgohet:

Anëtarëve

Arkivit

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi